

Hapet thirrja për aplikim për 3 (tre) bursa në kuadër të Programit Erasmus+ për stafin e UST pranë Universitetit Palacky, Olomouc-Çeki

Në kuadër të programit Erasmus + hapet thirrja për aplikim për 3 (tre) bursa për mobilitete për stafin me kohë të plotë të UST pranë Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin Palacky Olomouc.

Mobiliteti përfshin:

- Shkëmbimin e 2 (dy) anëtareve të stafit akademik për trajnim nga të gjitha njësitë e UST-së.
- Shkëmbimin e 1 (një) anëtari të stafit ndihmës akademik me karakter administrativ.

Kohëzgjatja e mobilitetit:

- 5 ditë + 2 ditë udhëtim

Bursa përfshin:

- Kompensimin ditor
- Koston e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës). Për të përcaktuar distancën, klikoni në linkun e mëposhtëm:
http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Bashkëlidhur do të gjeni në gjuhën angleze dhe informacionin e plotë për këtë javë ndërkombëtare.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. *Curriculum Vitae në gjuhën Angleze në formatin Europass;*
2. *Fotokopje e pasaportës;*
3. *Letër motivimi në gjuhën Angleze;*
4. *Certifikata që vërteton njohuritë e gjuhës Angleze.*
5. *Plani i Mobilitetit.*

Plani i mobilitetit

Për të shkarkuar formatin e planit të mobilitetit klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://ust.edu.al/erasmus-2/>

Plani i mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit.

Ky dokument firmoset vetem nga aplikanti në momentin e aplikimit.

Afati i fundit për aplikim: 29/05/2026

Dokumentet duhen dorëzuar në Zyrën e Protokollit në Rektoratin e Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe të skanuara në adresë: erasmus@ust.edu.al

Dokumentacioni i dorëzuar në zyrën e protokollit, duhet të shoqërohet me formularin e aplikimit që përmban të dhënat për çdo aplikant dhe duhet të firmoset nga ky i fundit.

Për të shkarkuar formularin klikoni në linkun: <https://ust.edu.al/erasmus-2/>

